

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata ndërkombëtare bllokoi qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyu SPAK për aeroportin e Vlorës
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/17/gjykata-nderkombetare-blokon-qeverine-rama-pse-nuk-nderhyn-spak-per-aeroportin-e-vlores/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:07:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:05:23 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b06a9213c815a85ff468b919a349a90b62aff3b77bb0bd2db22f3a5c2633aa8e
TEKSTI	d157a3cde5f6b3a3eb3c8625e1493897a73873299a64b76fc2c8137d9d35163d
PAMJA	d8698cbb30b52d6ebc88e98b7104af2a3699fc00bd41c5b4a00a508be04216b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3a0bd5edc68239c277ecf608338f840f910bdeebd36b59f073ed7a50daeec698
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3a0bd5edc68239c277ecf608338f840f910bdeebd36b59f073ed7a50daeec698>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Gjykata ndërkombëtare bllokoi qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyjnë SPAK për aeroportin e Vlorës

Urdhri i arbitrit të ICC-së frenoi qeverinë nga krijimi i një fakti të kryer në Aeroportin e Vlorës, duke mbrojtur përkohësisht jo vetëm interesat e MABCO-s, por edhe buxhetin shqiptar nga rreziku i një arbitrazhi me faturë prej qindra milionë eurosh.

15:05 : 17/09/2026 në AKTUALITET, KRYESORE, POLITIKE



Një arbitër ndërkombëtar në Londër bëri për Aeroportin e Vlorës atë që drejtësia e përgjurmur shqiptare nuk guxon dot ta bëjë prej muajsh: ka ngrirë konfliktin mes kompanive private dhe qeverisë para se gjoba me vlerë qindra milionë euro të kthehet në fakt të kryer dhe fatura t'i mbetet buxhetit të shtetit.

Më 16 shtator, Arbitri i Emergjencës i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), Cecilia Carrara, nxori një urdhrë paraprak në çështjen e hapur nga MABCO Constructions kundër Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

MABCO, kompania zvicerane e grupit Mabetex, zotëron 98% të Vlorë International Airport, ndërsa 2A Group 2%.

Urdhri ndalon Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të ndërmarrë veprime të tjera lidhur me përfundimin e kontratës që mund ta përkeqësojnë konfliktin ose ta bëjnë të pavlefshme procedurën.

Lexo edhe:

[Censurë, IA dhe deepfake: Lufta online rreth 'Revolucionit të Flamingove'](#)[Arbitrazhi i Londrës bllokoi qeverinë për shtetëzimin e Aeroportit të Vlorës](#)

MABCO iu drejtua ICC-së më 7 shtator, pasi Ministria kishte njoftuar prishjen e kontratës së koncesionit. Sipas dokumentit të arbitrazhit, prishja do të bëhej efektive më 17 shtator, vetëm një ditë pas nxjerrjes së urdhrit. Ky afat shpjegon edhe urgjencën e procedurave.

Pas hyrjes në fuqi të prishjes së kontratës, ministria mund të ndërhynte në projekt, të merrte në posedim ose nën kontroll operacional kantierin, asetet dhe punimet, të kërkonte dorëzimin

TË GJITHA



Dënimi ne Hagë ndaj ish-kreerëve të UÇK-së, analizë nga Adriatik Lapaj

15:07 : 17/09/2026



Gjykata ndërkombëtare bllokoi qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyjnë SPAK për aeroportin e Vlorës

15:05 : 17/09/2026



Kryeministri i Suedisë jep dorëheqjen pas humbjes së zgjedhjeve

15:01 : 17/09/2026



Kundërshtoi pezullimin e afateve të paraburgimit, Apeli rrëzon kërkesën e Ilir Metës

14:44 : 17/09/2026



OVL e UÇK-së thërret protestë popullore nesër në Prishtinë: Asnjë gjykatë s'e zhbën luftën çlirimtare

14:32 : 17/09/2026



A do ta lëshojë PS nëse SPAK kërkon sërish arrestimin? Berisha: Qeveria sot është Balluku-Rama

14:16 : 17/09/2026



Berisha-Spahiut: U betove për të mbrojtur aktet korruptive në shëndetësi, jep dorëheqjen sa më parë

14:12 : 17/09/2026

e pasurive dhe të zgjidhte një operator që do të zëvendësonte koncesionarin ekzistues.

MABCO argumentoi se, nëse kjo ndodhte, procedura emergjente humbiste kuptimin. Në Londër do të vazhdonte shqyrtimi i prishjes së kontratës, ndërsa në Vlorë qeveria mund ta kishte marrë aeroportin dhe mund të kishte vendosur një operator tjetër.

Arbitri e pranoi se ekzistonte rreziku që qeveria të merrte kontrollin e pronave apo të zëvendësonte VIA-n me një operator pasardhës.

Në dosje kishte edhe materiale të paraqitura nga MABCO që arbitri i përshkroi si “disa prova që sugjerojnë se MIE mund të jetë duke shqyrtuar emërimin e një operatori pasardhës”.

Në pikën 38 urdhërohet ministria të mos ndërmarrë veprime lidhur me përfundimin e koncesionit që ndryshe nënkupton se qeveria nuk mund ta kthejë prishjen e kontratës në një fakt të kryer ndërsa arbitri po shqyrton nëse duhet ta ndalojë atë.

Ndërhyrja e gjykatës në Londër ndryshon rrjedhën e konfliktit. Pa të, skenari ishte që qeveria të prishte kontratën, të merrte aeroportin, të largonte koncesionarin dhe eventualisht të vendoste një operator tjetër. MABCO do të vazhdonte më pas betejën në arbitrazh, këtë herë jo vetëm për kontrollin e aeroportit, por edhe për dëmin që pretendon se i është shkaktuar nga shteti shqiptar.

Pretendimet e MABCO-s për ekspozimin financiar të Shqipërisë kanë shkuar në qindra milionë euro, me një dëm potencial të pretenduar deri në 500-700 milionë euro, por rreziku financiar do të diskutohet në një konflikt arbitrar në themel. Kështu, masa që mbron sot interesin e një kompanie private mbron edhe një interes publik.

Kontrasti me atë që ndodhi prej muajsh brenda Shqipërisë është i dukshëm.

Konflikti i Aeroportit të Vlorës vazhdon prej muajsh. Nisi për kontrollin e Vlorë International Airport, vazhdoi me vendime gjykatash që prekën të drejtat e aksionerit me 98%, bllokim të kantierit, ndërhyrje institucionale dhe më pas procedurën e Ministrisë për prishjen e koncesionit.

Në dosjet hetimore të SPAK në lidhje me lotet e Unazës së re në Tiranë dolën komunikime mes personave që lidhen me këtë histori. SPAK ka administruar në hetimet e tij materiale që përfshijnë Arbër Abazin dhe Belinda Ballukun, ndërsa lidhjet e Abazit me Valon Ademin dhe rolet e personave të përfshirë në VIA janë elemente që kërkojnë verifikim për të përcaktuar nëse konflikti ishte pasojë e interesave korruptive.

Këto janë materiale që SPAK i ka në dosje, por që duhet t'i hetojë nëse materialet që disponon krijojnë dyshime për vepra penale. Nëse nga hetimi rezulton se veprime të caktuara mund të jenë produkt i një vepre penale, vazhdimi i tyre mund të prodhojë pasoja qindra miliona euro dëmë për qytetarët shqiptarë.

Prokurori Klodian Braho dhe SPAK duhet të sqarojnë çfarë materialelesh kanë për Aeroportin e Vlorës, çfarë tregojnë ato dhe nëse krijojnë bazë për të ndërhyrë para se konflikti të arrijë në pikën ku shteti shqiptar rrezikonte një tjetër betejë ndërkombëtare.

Nëse paratë ikin, atëherë drejtësia për aeroportin e Vlorës do t'i kushtojë shumë qytetarëve shqiptarë. Shqipëria e provoi këtë me inceneratorët, ku hetimet ngritën akuza dhe çuan personat përgjegjës para gjykatës, por ndërkohë kontratat ishin lidhur dhe paratë e buxhetit ishin paguar.

Në Vlorë ka ende kohë që historia të mos përfundojë njësoj. Mbetet të shihet nëse SPAK do të hetojë atë që ka ndodhur përpara se dëmi të prodhohet, apo do të mbërrijë përsëri me vonesë kur dëmi të jetë bërë./Lapsi.al

Etiketa: [aeroporti i Vlorës](#) [ICC](#) [qeveria Rama](#)

Lajme të lidhura



Censurë, IA dhe deepfake: Lufta online rreth 'Revolucionit të Flamurave'



Arbitrazhi i Londrës bllokoi qeverinë për shtetëzimin e Aeroportit të Vlorës



Behgjet Pacolli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës nën t'ia dhënë Do

1. Kategoria

08:23 : 17/09/2026



Kapja e shtetit, ligjet me porosi dhe kontratat publike

17:31 : 09/09/2026

2. Kategoria

22:51 : 16/09/2026



6 fakte që zbulojnë skenarin perfid të qeverisë për pagat e magistratëve

19:56 : 07/09/2026

3. Kategoria

14:10 : 13/09/2026



Vepër penale kur deputi/ja thotë: Fute këtë...!

12:04 : 05/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

f i y

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.